



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 49, Datë 24.05.2018

MONITORIM I KRYER NGA APP

Autoriteti Kontraktor	DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR. 3 E PUNËTORËVE TË QYTETIT, TIRANË
Hetim administrativ, iniciuar nga	• APP ☒ • Reklamim nga të tretë ☐
Numri i procedurave të monitoruara	1
Lloji i procedurës/ave të monitoruara	Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës
Konstatimet kryesore	Nga shqyrtimi i gjithë informacionit të administruar, në kuadër të hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik arriti në përfundimin se, autoriteti kontraktor, nuk ka justifikuar përdorimin e procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 33, pika 2, gërma “c” të ligjit të prokurimit publik dhe nenit 36, pika 2, gërma “c” të rregullave të prokurimit publik. Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka administruar dokumentacion, në lidhje me argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit, në kundërshtim me nenin 61 të rregullave të prokurimit publik.
Masat e marra	Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të nenit 72, pika 1, gërma “e” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka penalizuar me gjobë 4 (katër) persona, konkretisht: Titullari i autoritetit kontraktor dhe 3 (tre) anëtarë të Njesisë së Prokurimit.